

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

---

### Habitja / *el-Hejemaan* / الْهَيْمَان

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"وَأَخْرَجَ مُوسَىٰ صَعِقًا"

"Dhe Musës i ra të fikët."<sup>1</sup> (A'raf, 143)

Habitja është humbja e vetëkontrollit nga çuditja.<sup>2</sup> Kjo është më e qëndrueshme sesa *ed-Dehesh* (Shastisja) dhe përshkruhet më lehtë nga përjetuesi i saj.<sup>3</sup> Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është një habitje që rezulton nga të parët e shkëndijave të mirësisë me rastin e nismës së udhëtimit (në shtegun e pastrimit shpirtëror) ndërsa sheh pozitën tënde të neveritshme, nivelin tënd të papërfillshëm, dhe mospasjen e ndonjë vlere te ti.<sup>4</sup>

Niveli i dytë është habitja nga rrahjet e valëve të zbulimit me rastin e:

---

<sup>1</sup> Në *el-Medaarixh*, Ibn el-Kajim thekson se habitja s'është një shkallë që duhet kërkuar; ajo mund të jetë një ndodhi e papritur në shtegun (e pastrimit shpirtëror). Ai argumenton se kjo (habitja) s'është përmendur as në Kuran, as në Sunet, dhe as nuk është njohur nga mjeshtërit e hershëm të shtegut.

<sup>2</sup> Çuditja me prurjet shpirtërore që hasen dhe befasia që të vjen nga kjo.

<sup>3</sup> Për shkak se kjo zgjat më shumë dhe është më e qëndrueshme sesa *ed-Dehesh*, përjetuesi i saj mund ta përshkruajë.

<sup>4</sup> Të mos shohësh veten si të denjë për të pranuar mirësinë dhe hirin e Zotit. Pasi të marrësh disa hapa në rrugën për tek Ai, ti mund të kënaqesh me dhurimet që i pranon. Në *el-Medaarixh*, Imam Ibn el-Kajim thekson se frytet e të parit të pozitës së ulët që ke dhe të hirit të Zotit (ndaj teje) janë të shumta dhe madhështore, siç është përulësia, mirënjohja, gëzimi për mëshirën e Tij, devocioni, dashuria, e kështu me radhë.

- Manifestimit të provave të saj (habitjes)
- Ndodhjes së njëpasnjëshme të çudirave të saj
- Shfaqjes së dritës së saj<sup>5</sup>

Niveli i tretë është një habitje që ndodh me rastin e:

- Shpërbërjes në përparësinë (e Tij)<sup>6</sup>
- Të parët e sovranitetit të para-përjetësisë<sup>7</sup>
- Dhe zhytja në oqeanin e zbulimit<sup>8</sup>

---

<sup>5</sup> Ky nivel realizohet atëherë kur personi të nisë të përparojë në shtegun e pastrimit shpirtëror dhe nis të shtohet bindja e të zhvillohet përjetimi i besimit deri në masën që e bën të habitet me ndodhjen e njëpasnjëshme të provave të qarta, gjë që forcon besimin e tij dhe shqyen perdet.

<sup>6</sup> Përparësia absolute e Tij; të mos qenët i paraprirë nga ndonjë gjë dhe të qenët para çdo gjëje. Reflektimi i mjaftueshëm për këtë bën që vullneti personal të shpërbëhet në vullnetin e Tij dhe që Ai të jetë në qendër të vëmendjes, ku vetja përthithet pothuajse tërësisht në këtë përqendrim.

<sup>7</sup> Zhdukja – në krahasim - e gjërave të krijuara (*hawaadith*) nga të parët.

<sup>8</sup> Zbulimi i të Vërtetit para syve të zemrës, derisa të adhurosh Atë sikur ta shihje.